

Rekomandime për Propozim-Strategjinë Kombëtare të TIK-ut 2021-2025 dhe Planin aksional shoqëruar në lidhje me përfshirjen (inkluzionin) digjital

(rekomandimet janë dhënë në bazë të **Observatorit të Agjendës Digjitale - Raport mbi situatën aktuale dhe udhërrëfyes për avancimin e Agjendës Digjitale në Maqedoninë e Veriut të vitit 2020** dhe të vitit **2021**, dhe në kontekstin e përfshirjes (inkluzionit) digjitale)

- Edhe pse po bëhen përpjekje për vendosjen e të gjitha shërbimeve elektronike nga institucionet **Portalin kombëtar të shërbimeve elektronike** (Portali), disa shërbime elektronike ofrohen në mënyrë të pavarur nga institucionet. Rekomandohet që **të gjitha e-shërbimet shtetërore të ofruara nga institucionet në nivel kombëtar dhe lokal, të jenë të centralizuara në një vend, gjegjësisht të ofrohen përmes Portalit**. Pastaj, në kuadër të Portalit këshillohet të sigurohet **një databazë e unifikuar me të gjitha të dhënat për shërbimet elektronike** (informata mbi numrin e përdoruesve të regjistruar të ndara sipas personave juridikë dhe individë, informata mbi shërbimet më të kërkuara ose më të përdorura nga qytetarët dhe kompanitë, informata mbi numrin e e-shërbimeve të ofruara, të dhëna që rezultojnë nga matja e kënaqësisë së klientit, etj.). Kjo bazë të dhënash mund të përdoret më tej nga institucionet, shoqëria civile, komuniteti i biznesit, etj. sa i përket vendimmarrjes, krijimit të hulumtimeve dhe strategjive të detajuara, si dhe krijimit të zgjidhjeve inovative të TI-së.
- Iniciativa ADMV (Agjencia Digjitale e Maqedonisë së Veriut) gradualisht do të fusë shërbime të kompletuara për përdoruesit e fundit për ngjarjet kryesore të jetës duke e integruar ofrimin e shërbimeve nga pronarë të ndryshëm të të dhënave, duke përdorur Kornizën ekzistuese të ndërveprimit. Deri në fund të vitit 2025, të paktën pesë shërbime të tilla do të jenë funksionale", që është një hap i madh në drejtim të mirë. Paralelisht me këtë, rekomandohet të krijohet një **plan tranzicioni, gjegjësisht digitalizim i plotë i shërbimeve saktësisht të caktuara, me afate të përcaktuara saktësisht**, në të cilat opsioni për ta marrë atë shërbim në sportel do të kufizohet gradualisht, drejt heqjes së tij të plotë. Në të njëjtën kohë, **është e nevojshme të jepet mbështetje intensive për qytetarët në këtë drejtim**.
- Gjatë futjes në përdorim të **inovacioneve**, rekomandohet që institucionet të përpiqen **të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe praktikën e tyre pas një periudhe të caktuar kohore**, dhe për këtë arsye duhet të sigurohet kujdes adekuat për **funksionalitetin e tyre vazhdueshëm**. Në këtë drejtim, është e nevojshme të forcohet **bashkëpunimi me sektorin civil në fushën e "Hulumtimit dhe inovacioneve"**.
- Në lidhje me **ngritjen e vetëdijes për portalin e-Qeverisë dhe shërbimet elektronike**, dhe angazhimin që "deri në vitin 2022 duhet të miratohet një strategji dhe plan veprimi koherent komunikimi, në mënyrë që të rritet dukshmëria e shërbimeve të disponueshme për qytetarët", rekomandohet **përfshirja e sektorit civil në krijimin e këtyre dokumenteve strategjike**, i cili është një urë lidhëse midis qytetarëve dhe institucioneve, dhe që i kupton më së miri nevojat e qytetarëve. Për më tepër, rekomandohet që zbatimi i strategjisë të mbështetet nga një ekip i fortë marketingu për ta lehtësuar ndërgjegjësimin kolektiv për Portalin dhe kështu të zvogëlohet skepticizmi në lidhje me shërbimet elektronike. Në këtë drejtim, rekomandohet që Qeveria të caktojë një **zëdhënës**



Ky projekt është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian



ICEDA
Increasing Civic Engagement
in the Digital Agenda

(spokesperson), i cili do të raportoje rregullisht për përparimin për sa i përket zbatimit të Agjendës Digjitale (AD) dhe aktiviteteteve që lidhen me të, dhe të cilën qytetarët do ta njohin në këtë kontekst. Kjo është gjithashtu e nevojshme **për të ngritur vetëdijen e publikut për përfitimet nga AD-ja, si dhe për ta sjellë atë më pranë qytetarëve**. Në këtë drejtim, është e nevojshme të promovohen aktivitetet dhe bashkëpunimi nën ISA2, gjegjësisht rezultatet e zbatimit të AD-së të lidhen drejtpërdrejt edhe me anëtarësimin e ardhshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) në Bashkimin Evropian (BE);

- Në drejtim të mirë është edhe angazhimi për **forcimin e aftësive digjitale në hapësirat publike** duke siguruar qasje në TIK (lidhshmëri, pajisje, por edhe burime njerëzore për të mbështetur popullatën) në infrastrukturën dhe hapësirat publike, duke e zhvilluar rolin e bibliotekave publike për të përmirësuar përfshirjen digjitale, menaxhimin e 18 klubeve të internetit në të gjithë vendin dhe hulumtimin mbi rolin që do ta ketë rrjeti i ardhshëm për një pikë shërbimesh, si dhe duke zhvilluar shërbime të TIK-ut në hapësirat publike në mënyrë që çdo qytetar i RMV të ketë në dispozicion mjete dhe mënyra për t'i përmirësuar aftësitë e tij digjitale. Në funksion të **sigurimit të pajisjeve digjitale për kategoritë e cënueshme të njerëzve dhe mbledhjen dhe azhurnimin e pajisjeve digjitale** për shpërndarje të personat që kanë të drejtë për një ndihmë të tillë, është e këshillueshme që të konsultohen nismat që e kanë kryer këtë rol vullnetarisht gjatë pandemisë së KOVID-19 (p.sh. [Dhuro kompjuter](#)) në kuptim të shkëmbimit të përvojave dhe mundësive për sinergji.
- Lidhur me tejkalimin e hendekut digjital që ekziston midis një pjese të popullsisë dhe shoqërisë që tashmë jeton në botën digjitale, si dhe atyre që nuk zotërojnë asnjë pajisje digjitale, rekomandohet të sigurohet **ngritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave për informimin dhe edukimin e qytetarëve për Agjendën Digjitale dhe përfitimet e saj**. Organizatat e shoqërisë civile, si pika kryesore që punojnë drejtpërdrejt me qytetarët dhe tashmë janë të njohura me nevojat e tyre, mund të luajnë më tej rolin e shumëzuesve ku ata, me mbështetjen institucionale dhe financiare nga institucionet, do të jenë në gjendje të përhapin edukimin digjital të popullatës dhe të punojnë drejtpërdrejt me qytetarët në **zhvillimin e aftësive të tyre digjitale**.
- Në kuadër të ngritjes së shkathtësive digjitale të të gjithë qytetarëve, duhet të planifikohet edhe **zhvillimi i një programi arsimor në shumë nivele (fillor, i mesëm, i avancuar) që do të komunikoheshin në mënyrë të përshtatshme me moshën, aftësinë mendore dhe ekspertizën e qytetarëve nga të gjitha sferat**. Përveç zhvillimit të aftësive digjitale përmes arsimit formal (parashkollor, shkollor, të mesëm, të lartë), është e këshillueshme që të krijohen edhe programe të mësimi gjatë gjithë jetës për t'i përfshirë qytetarët që nuk janë pjesë e arsimit formal.

Theksojmë se përfshirja digjitale duhet të evoluojë së bashku me evoluimin e teknologjive të reja, që do të thotë gjithashtu investim në zvogëlimin dhe heqjen e barrierave historike, institucionale dhe strukturore për qasjen në dhe përdorimin e teknologjive.



Ky projekt është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian



Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda